

Nr. 1218/ Prot
Date 12.11.2020



**UNIVERSITETI
METROPOLITAN
TIRANA**

POLITIKA E CILËSISË E UNIVERSITETIT “METROPOLITAN TIRANA”

Politika e Cilësisë së Universitetit Metropolitan Tiranë është në respekt të vlerave të arsimit të lartë, të autonomisë akademike, të të drejtave të personelit akademik dhe administrative, si dhe të studentëve. Ky dokument mundëson politikën në lidhje me parimet kryesore të dhe standardet e cilësisë me sistemin e menaxhimit të cilësisë në Universitetin Metropolitan Tiranë. Mbi këto standarde (kriteret) cilësie përcaktohet plani i zhvillimit strategjik I institucionit, vlerësohet performance e institucionit me funksion të realizimit të vizionit të institucionit dhe dhe të arritjes së objektivave strategjike

Standardet e Cilësisë janë kriteret kryesore për të gjitha veprimtaritë akademike dhe personelin e Universitetit Metropolitan Tiranë. Përbushja e standardeve, si kriteret vlerësimi institucionale apo programesh, mund të përshtaten në mënyra të ndryshme në njësi të ndryshme.

Ky dokument i politikës së cilësisë, është përgatitur në përputhje me parimet bazë ASCAL (Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimi i Lartë në Shqipëri), të ENQA-s (Shoqata Evropiane për cilësinë) dhe të EUA (Shoqata Evropiane e Universiteteve).

1. MENAXHIMI

1.1 Misioni

Misioni është përcaktues dhe udhëheqës për aktivitetet institucionale dhe prioritetet institucionale. Ky mision mbështet nga pjesëmarrja e personelit akademik, personeli administrative dhe autoritetet drejtues të njësive përbërëse të UMT-së,

Misioni i UMT-së:

- a) Ofrimi i arsimit të lartë dhe veprimtarisë krijuese në fushat e shkencave të aplikuara dhe inxhinierisë, ekonomisë etj. në përputhje me kërkesat dhe nevojat e universitetit.
- b) Zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimtarisë akademike e kërkimit shkencor që kryhet brenda dhe jashtë vendit;
- c) Formimin e studiuesve të rinj në fushat e shkencave të aplikuara dhe inxhinierisë, ekonomisë etj., nëpërmjet programeve universitare mësimore-shkencore të një niveli të përparuar e bashkëkohor teorik, metodik e praktik.
- d) Thellimin e kualifikimit profesional e shkencor të specialistit të lartë në fushat e shkencave të aplikuara dhe inxhinierisë, ekonomisë etj. duke ofruar mundësi të mira për të përfutur nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës;
- e) Kontribuimin në mbështetje të prioritetëve strategjike dhe interesave të zhvillimit të

1.2 Struktura Organizative dhe Komunikimi

Struktura organizative është shpjeguese për hierarkinë e komunikimit ndërmjet njësive përbërëse të UMT-së, si dhe organet vendimmarrëse, vendimet e të cilëve zbardhen mbështetur në argumente. Ky komunikim, bashkëpunim dhe koordinim ndërmjet njësive përbërëse të UMT të përfshiranë aktivitetet arsimore, siguron që arsimimi kryhet për nevojat e studentëve, sipas programeve akademike të miratuara.

Lidhja dhe koordinimi për aktivitetet mësimore dhe kërkimore bazohet në komunikimin midis drejtuesve të njësive përkatëse (Aneksi I _Struktura e UT)

1.3 Qëllimet, Objektivat dhe Përmirësimi

Objektivi kryesor i UMT është ofrimi i arsimimit dhe veprimtarive akademike e shkencore me cilësi dhe shërbimeve cilësore ndaj studentëve.

Të gjitha njësitë përcaktojnë qëllimet dhe objektivat e tyre strategjike, bazuar në misionin institucional, dhe planifikimin dhe kryerjen e të gjitha aktiviteteve të kërkuara për arritjen e këtyre qëllimeve dhe objektivave.

Të gjitha njësitë vlerësojnë efektivitetin e aktiviteteve të tyre në arritjen e qëllimeve të planifikuara dhe objektivat në bazë të të dhënave të mbledhura, dhe përditësimin nëse është e nevojshme.

1.4 Nevojat e Burimeve

Titullarët e institucionit (top menagement) komunikojnë me drejtuesit e njësive për të përcaktuar dhe kërkuar facilitetet, infrastrukturë, mjetet dhe pajisjet, burimet njerëzore dhe burimet e tjera në funksion të sigurimit të cilësisë së arsimimit, kërkimit dhe veprimtarive të tjera, me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve në përputhje me qëllimet dhe objektivat.

Prioritetet përcaktohen në përputhje me misionin, qëllimet dhe objektivat e institucion me pjesëmarrjen e titullarëve të institucionit (Bordit Administrativ dhe Drejtuesve akademike).

1.5 Shpërndarja e Burimeve

Bordi i Administrimit mundëson burimet e nevojshme financiare, për të siguruar që aktivitetet të kryhen në përputhje me prioritetet, si dhe përmirësimin e cilësisë. Vlerësimi i të dhënave dhe matja e përfomancës janë indikatorë përcaktues në shpërndarjen e burimeve.

2. PERSONELI (akademik dhe jo akademik)

Përshkrimet e punës që përcaktojnë detyrat, autoritetet dhe përgjegjësitë, dhe kualifikimet e stafit përgatiten dhe përditësohen periodikisht. Kriteret për emërimin dhe ngritjen (promovimin)

në detyrë të personelit përcaktohen dhe miratohen nga organete autorizuar të universitetit (Departamenti, Dekanati dhe Rektorati).

Personeli (Akademik dhe jo akademik) i Universitetit Metropolitn Tirana është kompetent në fushat përkatëse të interesit. Nevojat për trajnim, përcaktohen dhe ofrohen trajnime gjatë ofrimit të shërbimit të personelit, me qëllim për të siguruar qëndrueshmëri dhe përditësim të kompetencave të tyre. Performanca e stafit vlerësohet në mënyrë periodike. Në vlerësimet e performancës, përmbajtja e përshkrimeve të punës përdoren si kriter themelore. Rezultatet e vlerësimit të performancës janë përcaktuese për personelin i cili do të angazhohet në vijimësi. Personeli informohet për rezultatet e vlerësimit të performancës.

2.1 Planifikimi i Burimeve Njerëzore

Burimet njerëzore të njësive përbërëse të UMT planifikohen në përputhje me planin strategjik të institucionit. Planifikimi i burimeve njerëzore bazohet në ngarkesat apo ndryshimet në këto ngarkesa pune, në përputhje me planin strategjik. Të dhënat lidhur me burimet njerëzore (praktikat për secilin personel) ruhen dhe sigurohen nga zyra përgjegjëse për Burimet njerëzore të UMT.

2.2. Personeli Akademik

Stafi akademik, përgjegjës për aktivitetin mësimor dhe kërkimor të UMT, ka kompetencë në kryerjen e veprimtarive akademike dhe kërkimore. Kompetencat e tyre mbështeten nga burimet dhe trajnimet e duhura. Personeli akademik i nënshtrohet vlerësimit të performancës, dhe informohet për rezultatet e vlerësimit të performancës.

2.3. Personeli Administrativ në funksion të procesit mësimor e shkencor

Personeli administrativ vlerësohet dhe emërohet në pozicionet përkatëse të punës, në përputhje me kualifikimet e specifikuar në përshkrimet e punës për çdo pozicion pune.

3. BURIMET INFRASTRUKTURE

Në rast nevojë, universiteti bashkëpunon me palët e tij të interesit dhe institucione të tjera në përputhje me misionin, qëllimet dhe objektivat e tij.

3.1 Menaxhimi i Objekteve

Një nga faktorët më të rëndësishëm që ndikon në cilësinë e shërbimeve që institucioni ka për të kryer në përputhje me misionin e saj është cilësia e objekteve (mjediseve) të përdorura për të kryer këto shërbime. Cilësia e objekteve është e lidhur ngushtë me sigurinë e punonjësve dhe studentëve. Universiteti përgatit plane të përshtatshme menaxhim i sigurt i mjediseve, dhe i zbaton ato.

Këto plane, si përfshirëse për të tjerët, janë si më poshtë:

- Plani i Sigurisë nga Zjarri dhe Evakuimit,
- Plani i Mirëmbajtjes dhe Riparimit të Klasave, Laboratorëve dhe Zyrave
- Plani i Mirëmbajtjes, Riparimi i Pajisjeve (p.sh. ashensorët, kondicioner, pajisje ngrohëse, sisteme energjetike),
- Plani i Mirëmbajtjes dhe Përditësimit për Hardëare dhe Softuer IT,
- Plani i masave anticovid (maska, materiale dezinfektuese, higjienizimindërtesës)

Prioritetet e zbatimit të planeve, kostot e përafërta dhe shpërndarja e burimeve vendosen bashkërisht nga drejtuesit e institucionit dhe Bordit i Administrimit.

3.2 Menaxhimi i Burimeve Informative

Institucioni siguron mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë e plan programeve të studimit, lidhur me burimet për të mbështetur procesin e të nxënës. Përveç stafit mësimdhënës, studentët gjithashtu mbështeten me burime informative, që do të kontribuojnë në edukimin e tyre. Këto burime janë biblioteka, pajisje kompjuterike dhe aksesit në internet, këshilltarë dhe mentorë.

Institucioni organizon dhe siguron burime informuese në bibliotekat dhe njësitë e tij, dhe pajisjet e hyrjes në internet në përputhje me nevojat dhe pritjet e studentëve dhe hulumtuesit. Institucioni vazhdimisht ndjek, rishikon dhe përmirëson burimet informuese për arsimin dhe kërkimin shkencor, bazuar në një sistem feedback për plotësimin e nevojave për studentët dhe akademikët.

4. PROCESET

Proceset akademike, kërkimore e shkencore, si dhe shërbime të tjera përcaktohen dhe menaxhohen nga secila njësi, në mënyrë që secili punonjës do të kryejë procesin në mënyrë standarde. Rregullat dhe procedurat parimore, veprimtaria dhe përgjegjësitë e çdopersoneliështë e përcaktuar.

4.1. Arsimimi

Proceset e formimit, përditësimit e miratimit dhe zbatimit të programeve të studimit përcaktohen dhe menaxhohen nga pjesëmarrja e studentëve. Në përcaktimin e proceseve të mësuarit rezultatet dhe nevojat e të mësuarit, merren në konsideratë burimet akademike, procedurat për ndjekjen e suksesit dhe zhvillimi i studentëve.

Proceset për regjistrimin e studentëve hartohen dhe menaxhohen në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Proceset për matjen dhe vlerësimin e performancës së studentëve hartohen dhe menaxhohen në përputhje me parimet bashkëkohore dhe ndërkombëtare.

Proceset e diplomimit, shkëputjes dhe dokumentacionit hartohen dhe menaxhohen në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

4.2. Kërkimi

Proceset e planifikimit, mbështetjes, realizimit dhe ndjekjes së kërkimit hartohen dhe menaxhohet nga njësitë akademike të UMT. Në këtë proces merret në konsideratë përdorimi efektiv dhe produktiv i burimeve në dispozicion.

5. PËRMIRËSIMI I CILËSISË

Menaxhimi i Cilësisë është filozofia kryesore e menaxhimit të institucionit. Institucioni mbështet përmirësimin e cilësisë dhe zhvillimin e aktivitetit të tij në këtë kontekst.

5.1 Kultura e Cilësisë

Përmirësimi i cilësisë, institucioni e kërkon si projekt për tu zbatuara nga personeli dhe njësitë e UMT-së. Kjo përbën objektivin strategjik të zhvillimit të afatmesëm dhe afagjatë të të Universitetit Metropolitan Tirana. Autoritetet drejtuese në vijimësi përpiqen për futjen e kulturës së cilësisë në të gjithë institucionin. Në këtë kuadër, personeli trajnohet në menaxhimin dhe përmirësimin e cilësisë, inkurajohet dhe mbështetet për të marrë pjesë në aktivitetet e përmirësimit të cilësisë.

5.2 Sistemi Aktiviteve për Cilësinë

Qasja e cilësisë në Universitetin Metropolitan Tirana bazohet në ciklin: planifiko-bëj-kontrollo-vepro. Lidhur me zbatimin e këtij cikli:

- Të gjitha aktivitetet në funksion të përmirësimit planifikohen. Objektivat për secilin aktivitet janë përcaktuar në bazë të të dhënave ekzistuese dhe informacionit në lidhje me aktivitetin.
- Propozimet për përmirësim bazohen në analizën e problemeve. Këto analiza kryhen përmes informacionit dhe metodave të përditësuara (përdorimi i manualeve dhe udhëzuesve).
- Planifikimi i projekteve pilot në njësi të zgjedhura, në rast se propozimet për përmirësim kanë volum dhe risk të lartë. Ky planifikim shtrihet në institucion, pas vëzhgimit të ndikimeve të tyre në njësitë e zgjedhura.
- Ndikimet e përmirësimit vlerësohen në bazë të krahasimit të të dhënave midis kohës së fillimit dhe kohës së mbarimit. Realizimi i objektivave të planifikuar më kohë është kritike. Nëse objektivat e planifikuara nuk arrihen, ato përditësohen duke marrë dhe masat e nevojshme.
- Nëse përmirësimi i planifikuar arrin rezultatet e pritura, ai përgjithësohet dhe institucionalizohet.
- Ndikimet e përmirësimit vlerësohen si të qëndrueshme dhe të vazhdueshme, bazuar në rishikimin e të dhënave periodike.

- Vendimet mbi procesit dhe ndryshimet e sistemit në kuadër të përmirësimit të cilësisë, bazohen në të dhëna dhe prova.

5.3 Treguesit e Cilësisë në Universitetin Metropolitan Tirana

Institucioni në vazhdimësi ndjek performancën e tij në fushën e aktiviteteve që kryen në realizimin e misionit të institucionit, nëpërmjet treguesve/indikatorëve, në përputhje me Kodin e Cilësisë (standardet shtetore të cilësisë institucionale dhe të programeve) si më poshtë:

- Cilësia në hyrje e studentëve,
- Arritjet dhe suksesi i studentit,
- Cilësia dhe punësimi i të diplomuarve,
- Vlerësimi i kurrikulës akademike,
- Cilësia e kërkimit,
- Cilësia e botimeve,
- Cilësia e shërbimeve,
- Menaxhimi i financave,
- Përdorimi efektiv i burimeve dhe kapaciteteve,
- Kënaqësia e studentëve,
- Kënaqësia e punonjësve,

Treguesit e performancës në vijimësi analizohen dhe vlerësohen nga staf kompetent. Të dhënat përkatëse krahasohen me të dhënat historike të institucionit dhe të dhënat të marra nga institucionet e tjera. Përcaktohen masat dhe duhura dhe aktivitetet përkatëse, bazuar në rezultate.

6. MENAXHIMI I SISTEMIT TË INFORMACIONIT (MSI)

Menaxhimi i sistemit të informacionit mbështet aktivitetet institucionale (te menaxhimit të përditshëm), veprimtaritë për përmirësimin cilësisë, procesin e vendimmarrjes dhe vendosjes së prioritetëve në institucion.

MSI ofron informacionin e nevojshëm për të ndjekur performancën bazuar në tregues /indikatorë të matshëm.

Lloji i informacionit për proceset e vendimmarrjes të nevojshme drejtuesit e UMT, vendosen bashkërisht nga titullarët e institucionit, personi përgjegjës për TIK, NJSBC dhe personi përgjegjës administrative për cilësinë.

Institucioni ka në funksion një sistem dokumentacioni. Ky sistem përcakton formatet, miratimin, njoftimin dhe funksionimin e dokumenteve; metoda e aksesit në dokumentacion; procesi i përditësimit, shfuqizimi dhe metodën e arkivimit të dokumentacionit;

7. INFORMACION PUBLIK

Institucioni publikon rregullisht informacione të përditësuara, objektive, sasiore dhe cilësore, në lidhje me arsimin, kërkimin dhe shërbimet që UMT ofron.

8. MARRËDHENIA ME AGJENCITË E SIGURIMIT TË JASHTËM TË CILËSISË

Proceset e të sigurimit të jashtëm të cilësisë vlerësojnë efektivitetin e sistemeve të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Institucioni vlerëson efektivitetin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë nëpërmjet vlerësimit të jashtëm të cilësisë. Rezultatet e vlerësimit bëhen publike nëpërmjet faqes zyrtare të institucionit.

Nikolla Civiçi


Struktura Organizative e Universitetit Metropolitan Tirana

